



VENDIM

Nr. 143, Datë 15.08.2016

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K., PËR VENDOSJE TË HIPOTEKËS MBI PASURITË E SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K NË FAVOR TË GREEN FOR GROËTH FUND SOUTHEAST EUROPE, OESTERREEICHISCHE ENTËICKLUNGBANK AG

Në mbështetje të neneve 16, 44 pika 1 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenet 6, 7 dhe 8 të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit, miratuar me vendimin e Bordit Nr. 119, Datë 21.07.2016, pika 1.3 e licensës “Për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016, mbasi shqyrtoi kërkesën për lënien si garanci hipotekore të asetëve të shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërma “a”** (ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licensuarit, të leshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); **“b”** (veprimtaria e licensuar); **“c”** (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve); **“e”** (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); **“f”** (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licensuarit); **“g”** (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licensuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licensuar); **“j”** (nese ka patur, listen e transferimeve të kryera me heret nga i njëjti subjekt), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me **Nenin 7, pika 1, gërmën “d”** (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); **“h”**

(marrëveshje paraprake e nenshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen) dhe “i” (deklarate me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehe gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me pale te tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit), do të njoftohet subjekti që ti paraqesë keto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurat per shqyrtimin e kerkeses se shoqerise “LENGARICA & ENERGY“ sh.p.k., për vendosje të Hipotekës mbi pasuritë e shoqërisë “LENGARICA & ENERGY ” sh.p.k. në favor të Green For Growth Fund Southeast Europe, Oesterreeichische Entëicklungbank AG.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.